



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. ____ / ____ Prot.

Fier, më .06.2024

Lënda: Formulari i njoftimit paraprak të fituesit për procedurën me objekt **“Blerje kancelari dhe letër”**, me burim financimi nga Buxheti i Bashkisë Fier.

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK
TIRANË
(për botim)

Shtojca 10

Bashkia Fier

Data: 10.06.2024

Drejtuar: Operatorit ekonomik ‘InfoSoft Office’ SHPK

Adresa: Tirane KASHAR Koder Kashar, Autostrada TiraneDurrës, Km 8
NUIS: J62426002Q

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur e thjeshtuar me mjete elektronike**

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-99380-03-26-2024.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje kancelari dhe letër”**, me fond limit/vlera e pritshme e kontratave prej **6 663 956** (gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë) dhe me TVSH prej **7 996 747.2** (shtatë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e dyzetë e shtatë pike dy), me burim financimi nga Bashkia Fier, në përputhje me preventivat, sasitë, specifikimet teknike dhe kushtet e përcaktuara në DST.

Afati kohor për ekzekutimin e kontratës: - **30 (tridhjetë) dite nga ditë nga nënshkrimi i kontratës.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [02 Prill 2024], [Numri 17].

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **PO**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik InfoSoft Office SHPK me NUIS J62426002Q. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 5 517 000 (pesë milion e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
2. Operatori ekonomik MARKETING & DISTRIBUTION me NUIS J72124001N. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 5 960 700 (pesë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
3. Operatori ekonomik IT Gjergji Kompjuter SHPK me NUIS K81503063B. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 6 070 000 (gjashtë milion e shtatëdhjetë mijë) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.
4. Operatori ekonomik LIBRARI DYRRAHU SHPK me NUIS L91418502J. Vlera totale sipas formularit të ofertës është 6 577 990 (gjashtë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH. Afati i dorëzimit sipas kërkesës së bërë.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik **LIBRARI DYRRAHU SHPK me numër NUIS L91418502J**

Perkatesisht per arsyet e meposhtme:

- **Operatori ekonomik LIBRARI DYRRAHU SHPK me NUIS L91418502J**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës LIBRARI DYRRAHU SHPK me NUIS L91418502J, konstatoi mangësit si më poshtë:

1. Referuar Shtojcës 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.3, përcaktohet se:

*” Operatori ekonomik duhet te paraqese skede teknike/katalog/broshure ose fragment katalogu ose broshure nga prodhuesi per zerin me nr. 52, leter fotokopje A4, **ge permban te dhena dhe specifikime teknike te artikullit me numer rendor nr.52 leter fotokopje A4, te cilat duhet te jene ne perputhje me karakteristikat apo specifikimet teknike te kerkuara nga autoriteti kontraktor, per kete artikull.** Ne rastin kur skeda teknike/ katalog/broshure ose fragment katalogu ose broshure eshte ne gjuhen shqipe, nuk ka nevojte te perkthehet dhe noterizohet por ne rastin kur eshte ne gjuhe te huaj duhet te jete i perkthyer ne gjuhen shqipe dhe i noterizuar.”*

Në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ka ngarkuar në sistem dokumentin me emertimin “Skede_Teknike”, në përmbajtje të të cilit janë pasqyruar të dhënat teknike për artikullin nr. 52 “Letër fotokopje A4”, ku pas krahasimit të tyre me specifikimet teknike të

kërkuara për këtë artikull nga Autoriteti Kontraktor evidentohen mospërputhje. Konkretisht, në skedën teknike, për letrën “Copy 1 class”, pasqyrohet:

- Lagështia 4.5 %, ndërkohë që Autoriteti Kontraktor kërkon që lagështia të jetë 3.0%-4.0%, referuar specifikimeve teknike në DST.
- Tejdrukshmëria 91 %, ndërkohë që Autoriteti Kontraktor kërkon që patejdrukshmëria të jetë >94 %, referuar specifikimeve teknike në DST.
- 2. Referuar Shtojcës 7, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, në pikën 2.3.5, përcaktohet se:

*“Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin mostrat (kampionet) **për disa prej artikujve te kërkuar si me poshte**, në ditën e hapjes së ofertave, në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit.*

- *Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues.*
- *Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.*
- *Mostrat do të dorëzohen perpara komisionit, ne oren dhe daten e percaktuar per hapjen e ofertave, ne Sallen e Mbledhjeve te Bashkise Fier, Kati II, Lagjja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15, Fier.”*

Në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik LIBRARI DYRRAHU SHPK, paraqiti mostrat (kampionet) për të gjithë artikujt e kërkuar në pikën 2.3.5, por ashtu siç edhe është konstatuar në procesverbalin e mbajtur për dorëzimin e mostrave, mostrat kishin të ngjitur etiketën por etiketa nuk përmbante: emrin e artikullit, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, si dhe emrin e ofertuesit.

Sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të nenit 80, nenit 92/3 të Ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 79, nenit 80, nenit 82 VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **InfoSoft Office SHPK, me NUIS J62426002Q**, me adrese: Tirane KASHAR Koder Kashar, Autostrada TiraneDurrës, Km 8,se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **5 517 000 (pesë milion e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH dhe prej 6,620,400 (gjashtë milion e gjashtëqind e njëzet mijë e katërqind) lekë me TVSH**, është identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
ZYRTARI I AUTORIZUAR**

Zv.Kryetari

Andius OLLDASHI